



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

**RREGULLORE**  
**“PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E DHËNIES SË AUTORIZIMEVE”**

*(Miratuar me Vendimin e Autoritetit të Mediave Audiovizive, Nr. 99, Datë 07.06.2017,  
ndryshuar me vendimin e AMA-s nr. 107, datë 21.11.2023, nr. 73, datë 22.08.2025  
dhe nr. 50, datë 26.05.2026)*

**KREU I**  
**TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Objekti dhe qëllimi i rregullores**

Kjo rregullore përcakton rregullat, kriteret dhe procedurat për dhënien e autorizimeve dhe afateve të tyre, në zbatim të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**Neni 2**  
**Përkufizime**

1. Termat e përdorur në këtë rregullore do kenë të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe në rast se nuk janë të përkufizuar në ligj do të jenë në përputhje me direktivat e BE për komunikimet elektronike, AVMSD (Direktiva për Shërbimet Mediatike Audiovizive) dhe aktet ndërkombëtare në fushën e shërbimeve audio/audiovizive ITU (Bashkimi Ndërkombëtar i Frekuencave) dhe CEPT (Konferenca Evropiane e Postës dhe Telekomunikacioneve) në fuqi.
2. Në zbatim të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
  - a) “AMA” është Autoriteti i Mediave Audiovizive.
  - b) “Autorizim” është leja që i jepet subjektit nga AMA, për ofrimin e shërbimit të programit audio dhe/ose audioviziv, ose përsëritjen e programit audio dhe/ose audioviziv të të tretëve, kur shërbimi mbështetet në një sistem satelitor, kabllor, në internet, si dhe për çdo shërbim tjetër, përfshirë shërbimin e aksesit të kushtëzuar.
  - c) “Aplikues” është personi fizik/juridik me seli në territorin e Republikës të Shqipërisë, i cili kërkon të pajiset me autorizim;
  - d) “Aplikim” është kërkesa për autorizim pasqyruar në formularin e aplikimit së bashku me dokumentacioni përkatës, që paraqitet në AMA nga aplikuesi;

- e) “Kritere” janë kushtet dhe kriteret për dhënien e autorizimeve, sipas llojeve, të përcaktuara në këtë rregullore;
- f) “Abonent” është marrësi i shërbimit të ofruar nga subjekti i autorizuar, në bazë të abonimit përkatës;
- g) “Akses i kushtëzuar” është çdo masë dhe/ose rregullim teknik që mundëson marrjen në formë të kuptueshme të shërbimeve të mbrojtura, kundrejt një autorizimi individual paraprak;
- h) “Pajisje e aksesit të kushtëzuar” është çdo pajisje ose program i projektuar ose i përshtatur për dhënien e aksesit në një shërbim të mbrojtur në një formë të kuptueshme dhe të qartë.
- i) “Përsëritje” është ofrimi i shërbimit të një programi audio dhe/ose audioviziv, nga subjekti i autorizuar në zbatim të dispozitave të kësaj rregulloreje, përmes ritransmetimit të njëkohshëm, të pandryshuar, përmes një sistemi kabllor, protokollit IP, ose mjeteve tokësore për shpërndarjen e një shërbimi transmetimi audioviziv për marrjen nga publiku, të një transmetimi fillestar, me tela apo mbi ajër, duke përfshirë edhe atë nga sateliti, e programeve audio dhe/ose audiovizive të destinuara për të mbërritur tek abonenti.
- j) “Platforma IPTV (Internet Protocol Television)” është një platformë teknologjike digjitale, përmbajtja dhe shërbimet audio dhe/ose audiovizive të së cilës, përcillen përmes bandës së gjerë në një rrjet IP të mbyllur dhe të administruar nga një ofrues i shërbimit internet [Internet Service Provider (ISP)], me shpejtësi dhe nivel cilësie të paracaktuar.
- k) “Platforma OTT (Over the Top)” është një platformë teknologjike digjitale, përmbajtja dhe shërbimet audio dhe/ose /audiovizive të së cilës, përcillen përmes protokollit IP në një rrjet të hapur dhe që nuk administrohet direkt nga ofruesi i shërbimit. Për ofruesin e këtij shërbimi abonentët janë të identifikueshëm dhe midis tyre lidhet marrëdhënie kontraktuale.
- l) “Shërbimi Internet TV” është një shërbim programi audio dhe/ose audioviziv që ofrohet përmes protokollit IP në një rrjet të hapur dhe që nuk administrohet direkt nga ofruesi i shërbimit. Aksesit në këtë lloj shërbimi është i hapur dhe nuk krijohet marrëdhënie kontraktuale midis ofruesit të shërbimit dhe përfituesit.

### Neni 3 Llojet e Autorizimeve

Autorizimet për shërbimin e programit audio dhe/ose audioviziv dhe autorizimet për përsëritjen e shërbimit të programit audio dhe/ose audioviziv lëshohen nga AMA për shërbimet e mëposhtme:

1. Satelitor, kur shërbimi mbështetet në rrjet satelitor. Subjekti i licencuar për transmetime audio ose audiovizive ka të drejtë të mbështetet në rrjetin satelitor, kundrejt regjistrimit në AMA. Autorizimet për ofrimin e shërbimeve të mbështetura në sistemin satelitor ndahen në:
  - 1.1. Autorizim për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv;
  - 1.2. Autorizim për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve;
  - 1.3. Autorizim për ofrimin e shërbimit të programit audio;

- 1.4 Autorizim për përsëritjen e shërbimit të programit audio të të tretëve.
2. **Kabllor**, kur shërbimi mbështetet në një sistem kabllor pavarësisht protokollit që përdoret për shpërndarjen e sinjalit drejt abonentit fundor (DVB-C, DVB-C2). Subjekti i licencuar për transmetime audio ose audiovizive ka të drejtë të mbështetet në rrjetin kabllor, kundrejt regjistrimit në AMA. Autorizimet për ofrimin e shërbimeve të mbështetura në sistemin kabllor ndahen në:
- 2.1 Autorizim për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv;
  - 2.2 Autorizim për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve;
  - 2.3 Autorizim për ofrimin e shërbimit të programit audio;
  - 2.4 Autorizim për përsëritjen e shërbimit të programit audio të të tretëve.
3. **Shërbimi online**, kur shërbimi mbështetet në rrjetet IP (*IPTV, OTT, Internet*). Subjekti i licencuar për transmetime audio ose audiovizive ka të drejtë të ofrojë shërbimin e tij programor mbështetur në rrjetet IP, kundrejt regjistrimit në AMA.
- 3.1 Autorizimet për ofrimin e shërbimeve të mbështetura në sistemin *IPTV*, ndahen në:
- 3.1.1. Autorizim për shërbimin e programit audioviziv;
  - 3.1.2. Autorizim për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve;
  - 3.1.3. Autorizim për shërbimin e programit audio;
  - 3.1.4. Autorizim për përsëritjen e shërbimit të programit audio të të tretëve.
- 3.2 Autorizimet për ofrimin e shërbimeve të mbështetura në sistemin *OTT*, ndahen në:
- 3.2.1. Autorizim për shërbimin e programit audioviziv;
  - 3.2.2. Autorizim për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve;
  - 3.2.3. Autorizim për shërbimin e programit audio;
  - 3.2.4. Autorizim për përsëritjen e shërbimit të programit audio të të tretëve
- 3.3 Autorizimet për ofrimin e shërbimeve të mbështetura në sistemin *Internet* ndahen në:
- 3.3.1. Autorizim për shërbimin e programit audioviziv;
  - 3.3.2. Autorizim për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve;
  - 3.3.3. Autorizim për shërbimin e programit audio;
  - 3.3.4. Autorizim për përsëritjen e shërbimit të programit audio të të tretëve

## **KREU II**

### **KRITERET DHE PROCEDURAT PËR DHËNIEN E AUTORIZIMEVE**

#### **Seksioni I**

#### **Kriteret për dhënie e autorizimeve**

#### **Neni 4**

#### **Kriteret e përgjithshme për dhënie e autorizimeve**

1. Ofrimi i shërbimit të programit audio dhe/ose audioviziv, kur shërbimi mbështetet në rrjete të ndryshme nga rrjetet tokësore analoge apo numerike dhe përsëritja e shërbimit të

programit audio dhe/ose audioviziv të të tretëve bëhet me autorizim të AMA-s, pa garë, mbi bazën e aplikimit pranë AMA.

2. Ofrimi i shërbimit të përsëritjes së programit audio dhe/ose audioviziv të të tretëve kur shërbimi mbështetet në rrjet kabllor, satelitor, OTT dhe IPT, bëhet me autorizim të AMA-s, pa garë, mbi bazën e aplikimit pranë AMA. Subjekti aplikues duhet të jetë i regjistruar në Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të depozitohet pranë AMA-s, Certifikatën e Konfirmimit të Njoftimit në AKEP.
3. Aplikuesi për ofrimin e shërbimit të programit audio dhe/ose audioviziv, kur shërbimi mbështetet në sistem Kabllor, Satelitor, IPTV, OTT dhe Internet TV duhet të dorëzojë kontratën të paktën me një subjekt të autorizuar nga AMA për përsëritjen e shërbimit të programit audio dhe/ose audioviziv të të tretëve, mbështetur në rrjet Kabllor, Satelitor, IPTV, OTT dhe Internet TV.
4. Aplikuesi për përsëritjen e shërbimit të programit audio dhe/ose audioviziv të të tretëve mbështetur në sistemet OTT ose Internet TV nuk është i detyruar të depozitohet Certifikatën e Konfirmimit të Njoftimit në AKEP.
5. Zona e ofrimit të shërbimit të programit audio dhe/ose audioviziv dhe përsëritjes së shërbimit të programit dhe/ose audioviziv mbështetur në sistem kabllor, internet IPTV duhet të jetë në përputhje me ndarjet administrative territoriale të përcaktuara në ligjin nr. 115/2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”. Zona minimale e ofrimit të shërbimit të programit audio dhe/ose audioviziv dhe përsëritjes së shërbimit të programit audioviziv mbështetur në sistem kabllor, Internet, IPTV fillon nga niveli i njësive administrative.
6. Autorizimi për ofrimin e shërbimit të programit audio dhe/ose audioviziv dhe për përsëritjen e shërbimit të programit audio dhe/ose audioviziv të të tretëve do të miratohet vetëm për transmetime të teknologjisë digjitale.
7. Rinovimi i autorizimit për ofrimin e shërbimit të programit audio dhe/ose audioviziv të të tretëve do të miratohet vetëm për transmetime të teknologjisë digjitale.
8. Aplikuesi për marrje autorizimi, rinovim autorizimi ose zgjerim të zonës së ofrimit të shërbimit përpara depozitimit të aplikimit, ose brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit për detyrimin nga AMA, duhet të kryejë pagesën për përpunimin e dokumentacionit, në të kundërt aplikimi i tij arkivohet pa u shqyrtuar.
9. Aplikuesi për marrjen e autorizimit, rinovimit ose zgjerimit të zonës së ofrimit të shërbimit të përcaktuara në këtë rregullore, mbështetur në rrjet kabllor, satelitor, shërbime online, Internet TV, IPTV, dhe OTT duhet të deklarojë dhe të respektojë kushtet e mëposhtme:
  - a. të pajiset me dekodera apo (pajisje të ngjashme) të cilët funksionojnë vetëm në modulimin e transmetimit për të cilën ka marrë autorizim nga Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA).
  - b. dekoderat nuk duhet të jenë të konfigurueshëm apo të përdoren për transmetim në modulime të tjera përveç asaj të autorizuar nga Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA)
  - c. është përgjegjës dhe mbart detyrimin për të siguruar që dekoderat/pajisjet teknike të ofruara për t’u përdorur gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së autorizimit të jenë në përputhje të plotë me autorizimin e dhënë nga AMA. Çdo përdorim i dekoderave në kundërshtim me

autorizimin përbën shkelje të kushteve të autorizimit dhe do të ndiqet sipas legjislacionit në fuqi.

## **Neni 5**

### **Kriteret financiare për dhënien e autorizimeve**

1. Autorizimi i shërbimit të programit audio dhe/ose audioviziv dhe autorizimi për përsëritjen e shërbimit të programit audio dhe/ose audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet satelitor u jepet subjekteve që kanë kapital të deklaruar e të nënshkruar, të depozituar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, ose të vërtetuar nga eksperti kontabël i miratuar/autorizuar, në masën jo më pak se 3.500.000 lekë.
2. Autorizimi i shërbimit të programit audio dhe/ose audioviziv dhe autorizimi për përsëritjen e shërbimit të programit audio dhe/ose audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor u jepet subjekteve që kanë kapital të deklaruar, të nënshkruar, të depozituar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, ose të vërtetuar nga eksperti kontabël i miratuar/autorizuar, në masën jo më pak se 10.000.000 lekë.
3. Autorizimi i shërbimit të programit audio dhe/ose audioviziv dhe autorizimi për përsëritjen e shërbimit të programit audio dhe/ose audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjetet IPTV dhe OTT, u jepet subjekteve që kanë kapital të deklaruar e të nënshkruar, të depozituar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, ose të vërtetuar nga eksperti kontabël i miratuar/autorizuar, në masën jo më pak se 10.000.000 lekë.
4. Autorizimi i shërbimit të programit audio dhe/ose audioviziv dhe autorizimi për përsëritjen e shërbimit të programit audio dhe/ose audioviziv të të tretëve mbështetur në Internet TV, u jepet subjekteve që kanë kapital të deklaruar, të nënshkruar, të depozituar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, ose të vërtetuar nga eksperti kontabël i miratuar/autorizuar, në masën jo më pak se 5.000.000 lekë.
5. Kushteve të mësipërme i nënshtrohen edhe subjektet që aplikojnë për rinovimin e autorizimit/ zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit për subjektet e pajisur me autorizim.

## **Neni 6**

### **Kriteret lidhur me pronësinë**

1. Autorizimi për shërbimin e programit audio dhe/ose audioviziv mbështetur në rrjet satelitor u jepet shoqërive aksionare të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, sipas ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, me objekt ekskluziv veprimtarinë audiovizive.
2. Autorizimi për shërbimin e programit audio dhe/ose audioviziv mbështetur në rrjet kabllor dhe në rrjete IP, i jepet personave fizikë dhe/ose juridikë të regjistruar në Republikën e Shqipërisë sipas ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, që kanë në objekt të veprimtarisë shërbimet audio dhe/ose audiovizive.
3. Aksionet që përfaqësojnë kapitalin në një shoqëri, mbajtëse të një autorizimi për shërbim satelitor për transmetim audio dhe/ose audioviziv, janë nominativë.
4. Një person fizik ose juridik, që ka aksione në një shoqëri që disponon një autorizim për shërbim satelitor transmetimi audio dhe/ose audioviziv, nuk mund të ketë më shumë se

- 20 % të kapitalit të përgjithshëm në një shoqëri të dytë, që zotëron një licencë kombëtare transmetimi audio, ose licencë kombëtare të transmetimit audioviziv.
5. Për transmetimet analoge audio lejohet pjesëmarrja në masën deri në 10 % në një shoqëri të tretë kombëtare. Një person i tillë nuk lejohet të marrë licencë transmetimi audio, lokale apo rajonale ose licencë transmetimi audioviziv, lokale apo rajonale.

## **Seksioni II**

### **DOKUMENTACIONI PËR MARRJEN E AUTORIZIMIT**

#### **Neni 7**

##### **Formulari i Aplikimit**

1. Aplikuesi për autorizim për shërbimin e programit audio dhe/ose audioviziv dhe autorizim për përsëritjen e shërbimit të programit audio dhe/ose audioviziv të të tretëve duhet të depozitojë pranë AMA aplikimin në përputhje me kërkesat e kësaj rregullore. Aplikimi përbëhet nga formulari i aplikimit dhe dokumentacioni shoqërues.
2. AMA miraton përmbajtjen dhe formën e formularit të aplikimit sipas modelit bashkëlidhur rregullores në Aneksin I.
3. Formulari i aplikimit është pjesë përbërëse e dokumentacionit të aplikimit.
4. Aplikuesi duhet të plotësojë në mënyrë të saktë dhe të plotë të dhënat e formularit të aplikimit, në përputhje me dokumentacionin e aplikimit.
5. Formulari i aplikimit mund të shkarkohet nga aplikuesi në faqen zyrtare në internet të AMA-s, ose mund të tërhiqet pa pagesë pranë zyrave të AMA-s.

#### **Neni 8**

##### **Dorëzimi i aplikimit**

1. Aplikuesi për autorizim për shërbimin e programit audio dhe/ose audioviziv dhe autorizim për përsëritjen e shërbimit të programit audio dhe/ose audioviziv të të tretëve mund të dërgojë aplikimin me postë ose të depozitohet dorazi në protokollin e AMA-s.
2. Aplikimi duhet të paraqitet i mbyllur në zarf, i cili duhet të jetë i vulosur, firmosur dhe me mbishkrimin ku të saktësohet aplikimi përkatës. Në rastin e personave fizikë, të cilët nuk kanë vulë, zarfi i aplikimit duhet të jetë detyrimisht i firmosur.
3. Aplikuesi në zarfin e aplikimit duhet të pasqyrojë në mënyrë të qartë identitetin dhe adresën e saktë të tij.
4. Aplikimi duhet të përmbajë dokumentacion origjinal, ose fotokopje të noterizuar. Dokumentacioni që përmban zarfi duhet të dërgohet edhe i skanuar në format elektronik PDF dhe i ruajtur në CD/DVD/Disk USB.
5. Çdo dokument, që merret në institucionet shtetërore, duhet të jetë marrë jo më vonë se 30 ditë nga momenti i dorëzimit të aplikimit në AMA.

6. Pikat 1 – 5 të këtij neni aplikohen edhe në rastin e plotësimit të të metave të aplikimit fillestar. Në këtë rast subjekti aplikues, përveç të dhënave që kërkohen më sipër, duhet të pasqyrojë, mbi zarf, edhe shënimin “Për plotësim aplikimi”.

## Neni 9

### **DOKUMENTACIONI PËR MARRJE AUTORIZIMI PËR OFRIMIN E SHËRBIMIT TË PROGRAMIT AUDIO DHE/OSE AUDIOVIZIV DHE PËRSËRITJEN E SHËRBIMIT TË PROGRAMIT AUDIO DHE/OSE AUDIOVIZIV TË TË TRETËVE**

1. Aplikimi për marrjen e autorizimit për ofrimin e shërbimit të programit audio dhe/ose audioviziv duhet të përmbajë dokumentacionin i cili vërteton përmbushjen e kërkesave si më poshtë vijon:

#### **1.1.Kërkesat juridike**

- a. Emërtimi, vendndodhja e subjektit që depoziton aplikimin.
- b. Ekstrakti i thjeshtë dhe historik për të dhënat e subjektit lëshuar nga Qendra Kombëtare të Biznesit (QKB) për subjektin që bën kërkesën, bashkë me emrin dhe firmën e personit, që ka të drejtë t’a përfaqësojë atë, kur nuk përfaqësohet direkt nga përfaqësuesi ligjor, lëshuar jo më vonë se 30 ditë nga paraqitja e aplikimit.
- c. Emërtimi tregtar i ofruesit të shërbimit dhe rrjetit ku do të mbështetet.

#### **1.2.Kërkesat teknike**

- a. Përshkrim të përgjithshëm të shërbimit që kërkohet të ofrohet.
- b. Projekti teknik i instalimit dhe shfrytëzimit të pajisjeve, shoqëruar me bllokskemat të cilat paraqesin realizimin e shërbimit deri tek përdoruesi fundor (mënyrat e lidhjes).
- c. Lista e pajisjeve teknike që do të përdoren për ofrimin e shërbimit, tipin dhe karakteristikat teknike të tyre.
- d. Përshkrim mbi sistemet software që do të përdoren për ofrimin e shërbimit (nëse do të përdoren).
- e. Fazat e implementimit të projektit për realizimin me mbulim të zonës së shërbimit.
- f. Projekti i studios së prodhimit shoqëruar me bllokskemën e funksionimit të studios.
- g. Përshkrimi i sistemit dhe mënyrës së faturimit të abonentëve në rastin kur ndërton rrjetin e ofrimit të shërbimit.
- h. Masat për sigurimin e vazhdimësisë së transmetimeve në rast të ndërprerjes së energjisë apo defekteve teknike të mundshme.
- i. Adresa e faqes së internetit ku do të ofrohet shërbimi (në rastin e shërbimit Internet TV).
- j. Përshkrim i sistemit të kodit të aksesit të shërbimit (në rastin kur aplikohet).

#### **1.3.Kërkesat programore**

- a. Karakteri i përgjithshëm ose i tematizuar të shërbimit që ofron.
- b. Të dhëna për përmbajtjen e programeve të cilat shprehin qartë, në tërësinë e tyre, kërkesat për zbatimin e parimeve themelore të veprimtarisë audiovizive, si dhe pluralizmin dhe paanësinë e informacionit.

- c. Shenja dalluese identifikuese.
- d. Përshkrim të përmbajtjes së emisioneve dhe rubrikave kryesore që janë pjesë e tyre.
- e. Të dhënat statistikore për llojet e programeve që parashikon të transmetojë si: informacion, kulturë, art, argëtim, zbavitje, programe për fëmijë, sport, reklamë etj.;
- f. Programi javor që parashikon të transmetojë.
- g. Orë transmetimi në ditë, raportin e kohës së transmetimit që do të zënë programet e prodhuara vet në raport me kohën e përgjithshme të transmetimit dhe programet e veta.

#### **1.4. Kërkesat lidhur me mbikëqyrjen**

- a. Kontrata me një subjekt të autorizuar nga AMA për përsëritjen e shërbimit të programit audio dhe/ose audioviziv të të tretëve, mbështetur në rrjet kabllor, satelitor, internet ose Certifikatën e Konfirmimit të Njoftimit lëshuar nga AKEP, origjinal ose kopje e noterizuar.
- b. Dokumentacioni ligjor që vërteton të drejtën e transmetimit të programeve.
- c. Adresa e detajuar e ambientit (studios) ku janë të instaluara pajisjet audiovizive transmetuese të subjektit, e shoqëruar me kopje të noterizuar të dokumentit të pronësisë. Në rast se subjekti ka më shumë se një ambient (studio), adresat e detajuara të secilës prej tyre. Në rast se ambienti nuk është në pronësi të aplikuesit, së bashku me dokumentin e pronësisë duhet të depozitohet edhe dokumenti që vërteton të drejtën e tij të shfrytëzimit (kontratë përdorimi, qiraje, etj.).

#### **1.5. Kërkesat mbi burimet njerëzore.**

- a. Lista emërore e anëtarëve të Bordit Drejtues jo më pak se 5 anëtarë
- b. Curriculum Vitae (CV) përkatëse të çdo anëtari.
- c. Jo më pak se dy prej anëtarëve të bordit të kenë eksperiencë në fushën e medias, komunikimit, gazetarisë, inxhinierisë, financës dhe shoqërisë civile.
- d. Të dhëna të paraqitura në formën e një deklaratë mbi numrin e punonjësve që parashikon të punësojë me kohë të plotë jo më i vogël se 4;
- e. Nëse shërbimi ofrohet nga palë të treta, aplikuesi në këtë rast duhet të paraqesë kontratat e punës të nënshkruara me këto subjekte.
- f. Caktimi i një personi kontakti, si dhe të dhënat e tij (numër telefoni, adresë email-i, etj).

#### **1.6. Kërkesat ekonomike**

- a. Dokumentet që vërtetojnë të dhënat zyrtare e bankare mbi kapitalin financiar të personit juridik apo fizik që bën kërkesën, numrin ose numrat e llogarive bankare të subjektit.
- b. Kodi NIPT.
- c. Lista e administratorëve, parashikimet për shpenzimet dhe të ardhurat, në mënyrë të detajuar (llojet e të ardhurave, shpenzimet fikse, të ndryshueshme, detyrimet tatimore, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, origjinën dhe vlerën e investimeve që parashikohen të kryhen gjatë periudhës së vlefshmërisë së autorizimit).
- d. Aplikuesi duhet të depozitojë garancinë bankare, të ngurtësuar në favor të Autoritetit të

Mediave Audiovizive, në masën prej 10% të kapitalit të kërkuar për autorizimin për të cilin shfaqet interes, për një periudhë 9 mujore duke filluar nga data e paraqitjes së aplikimit.

2. Aplikimi për marrjen e autorizimit për përsëritjen e shërbimit të programit audio dhe/ose audioviziv të të tretëve duhet të përmbajtë dokumentacionin, i cili vërteton përmbushjen e kërkesave si më poshtë vijon:

### 2.1. Kërkesat juridike

- a. Emërtimi, vendndodhja e subjektit që depoziton aplikimin.
- d. Ekstrakti i thjeshtë dhe historik për të dhënat e subjektit lëshuar nga Qendra Kombëtare të Biznesit (QKB) për subjektin, që bën kërkesën, bashkë me emrin dhe firmën e personit, që ka të drejtë ta përfaqësojë atë, kur nuk përfaqësohet direkt nga përfaqësuesi ligjor lëshuar jo më vonë se 30 ditë nga paraqitja e aplikimit.
- b. Emërtimi tregtar i ofruesit të shërbimit dhe rrjetit ku do të mbështetet.
- c. Certifikata e Konfirmimit të Njoftimit lëshuar nga AKEP (në rastin e rrjeteve kabllore, satelitore dhe IPTV)
- h. Shenja dalluese identifikuese (logo).

### 2.2. Kërkesat teknike

- a. Përshkrimi i përgjithshëm të shërbimit që kërkohet të ofrohet.
- b. Projekti teknik i instalimit dhe shfrytëzimit të aparaturave, shoqëruar me bllokskemat të cilat paraqesin realizimin e shërbimit deri tek përdoruesi fundor (mënyrat e lidhjes).
- c. Lista e pajisjeve teknike që do të përdoren për ofrimin e shërbimit, tipi dhe karakteristikat teknike të tyre.
- d. Përshkrimi mbi sistemet softwareve që do të përdoren për ofrimin e shërbimit (nëse do të përdoren).
- e. Fazat e implementimit të projektit për realizimin me mbulim të zonës së shërbimit
- f. Harta e penetrimit me sinjal të sistemeve kabllore dhe IP.
- g. Përshkrimi i sistemit dhe mënyrës së faturimit të abonentit.
- h. Masat për sigurimin e vazhdimësisë së transmetimeve në rast të ndërprerjes së energjisë apo defekteve teknike të mundshme.
- i. Adresa e faqes së internetit ku do të ofrohet shërbimi (në rastin e shërbimit Internet TV).
- j. Përshkrimi i sistemit të kodit të aksesit të shërbimit (në rastin kur aplikohet).

### 2.3. Kërkesat lidhur me mbikëqyrjen

- a. Kontrata/t paraprake ose kontrata/t për kalimin e të drejtave të transmetimit me OSHMA-të, mbajtëse të këtyre të drejtave, origjinal ose fotokopje e noterizuar.
- b. Lista e programeve që do të ritransmetojë sipas kontratës.
- c. Adresa e detajuar e ambientit (studios) ku janë të instaluarat pajisjet audiovizive transmetuese të subjektit, e shoqëruar me kopje të noterizuar të dokumentit të pronësisë. Në rast se subjekti ka më shumë se një ambient (studio), adresat e detajuara të secilës prej tyre. Në rast se ambienti nuk është në pronësi të aplikuesit, së bashku me dokumentin e pronësisë duhet të depozitohet edhe dokumenti që vërteton të drejtën e tij të shfrytëzimit (kontratë përdorimi, qiraje, etj.).

#### **2.4. Kërkesat mbi burimet njerëzore**

- a. Lista emërore e anëtarëve të bordit drejtues jo më pak se 3 anëtarë.
- b. Curriculum Vitae (CV) përkatëse të çdo anëtari .
- c. Të dhëna të paraqitura në formën e një deklarate mbi numrin e punonjësve që parashikon të punësojë me kohë të plotë jo më i vogël se 3.
- d. Nëse shërbimi ofrohet nga palë të treta, aplikuesi në këtë rast duhet të paraqesë kontratat e punës të nënshkruara me këto subjekte.
- e. Caktimi i një personi kontakti, si dhe të dhënat e tij (numër telefoni, adresë email-i, etj).

#### **2.5. Kërkesat ekonomike**

- a. Dokumentet që vërtetojnë të dhënat zyrtare e bankare mbi kapitalin financiar të personit juridik apo fizik që bën kërkesën, numrin ose numrat e llogarive bankare të subjektit.
- b. Kodi NIPT.
- c. Lista e administratorëve, parashikimet për shpenzimet dhe të ardhurat; në mënyrë të detajuar, (llojet e të ardhurave, shpenzimet fikse, të ndryshueshme, detyrimet tatimore, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, origjinën dhe vlerën e investimeve, numrin e abonentëve dhe tarifën mujore që parashikohet për periudhën e vlefshmërisë së autorizimit.
- d. Aplikuesi duhet të përcaktojë edhe numrin e parashikuar të abonentëve dhe tarifat që parashikon të aplikojë.
- e. Aplikuesi duhet të depozitojë garancinë bankare, të ngurtësuar në favor të Autoritetit të Mediave Audiovizive, në masën prej 10 % të kapitalit të kërkuar për autorizimin për të cilin shfaqet interes, për një periudhë 9 mujore duke filluar nga data e paraqitjes së aplikimit.

### **Neni 10**

#### **DOKUMENTACIONI PËR RINOVIMIN E AUTORIZIMIT**

1. AMA gjatë shqyrtimit të aplikimit për rinovimin e autorizimit të subjektit të pajisur me autorizim për ofrimin e shërbimit të programit audio dhe/ose audioviziv verifikon respektimin e kushteve teknike, juridike, organizative, financiare, e programore për periudhën që ka ushtruar veprimtari audio dhe audiovizive.
2. Aplikimi për rinovimin e autorizimit për ofrimin e shërbimit të programit audio dhe/ose audioviziv duhet të përmbajë dokumentacionin i cili vërteton përmbushjen e kërkesave si më poshtë vijon:

##### **2.1. Kërkesat juridike**

- a. Kërkesat juridike për aplikimin për rinovimin e autorizimit janë të njëjta me ato të përcaktuara në nenin 9, pika 1.1.

##### **2.2. Kërkesat teknike**

- a. Përshkrim mbi përmbushjen e kushteve teknike të përcaktuara në autorizimin e

mëparshëm që ato kërkojnë të rinovojnë, gjatë periudhës së vlefshmërisë së këtij autorizimi.

- b. Projekti teknik të instalimit dhe shfrytëzimit të aparaturave, shoqëruar me bllokskemat të cilat paraqesin realizimin e shërbimit deri tek përdoruesi fundor.
- c. Lista e pajisjeve teknike që do të përdoren për ofrimin e shërbimit, tipin dhe karakteristikat teknike të tyre.
- d. Përshkrimi i sistemit dhe mënyrës së faturimit të abonentit.

### 2.3. Kërkesat programore

- a. Karakteri i përgjithshëm ose i tematizuar të shërbimit që ofron.
- b. Të dhëna për përmbajtjen e programeve të cilat shprehin qartë, në tërësinë e tyre, kërkesat për zbatimin e parimeve themelore të veprimtarisë audiovizive, si dhe pluralizmin dhe paanësinë e informacionit.
- c. Shenja dalluese identifikuese.
- d. Përshkrimi i përmbajtjes së emisioneve dhe rubrikave kryesore që janë pjesë e tyre;
- e. Të dhënat statistikore për llojet e programeve që parashikon të transmetojë si p.sh. informacion, kulturë, art, argëtim, zbavitje, programe për fëmijë, sport, reklamë etj.
- f. Programi javor që parashikon të transmetojë.
- g. Orë transmetimi në ditë, raportin e kohës së transmetimit që do të zënë programet e prodhuara vet në raport me kohën e përgjithshme të transmetimit dhe programet e veta

### 2.4. Kërkesat lidhur me mbikëqyrjen

- a. Kërkesat për mbikëqyrjen për aplikimin për rinovimin e autorizimit janë të njëjta me ato të përcaktara në nenin 9, pika 1.4.

### 2.5. Kërkesat mbi burimet njerëzore

- a. Kërkesat për burimet njerëzore për aplikimin për rinovimin e autorizimit janë të njëjta me ato të përcaktuara në nenin 9, pika 1.5, përveç gërmës d, e cila kërkohet si më poshtë: *“Pagesat e detyrimeve të sigurimeve shoqërore për punonjësit e siguar (jo më pak se 4 për të gjithë periudhën e mëparshme të autorizimit), të paraqitura në formën e një vërtetimi të marrë nga organi kompetent”*.
- b. Përjashtimisht, OSHMA-të që operojnë në bashki ku numri i banorëve është më i vogël se 30.000, pagesat e detyrimeve të sigurimeve shoqërore për punonjësit e siguar *(jo më pak se 2 (dy) për të gjithë periudhën e mëparshme të autorizimit) të paraqitura në formën e një vërtetimi të marrë nga organi kompetent ose nëpërmjet marrëveshjeve/kontratave me palë të treta në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

### 2.6. Kërkesat ekonomike

- a. Kërkesat ekonomike për rinovim autorizimi janë të njëjtat ato të përcaktuara në nenin 9, pika 1.6, përveç gërmës d.

3. Aplikimi për rinovim e autorizimit për përsëritjen e shërbimit të programit audio dhe/ose audioviziv të të tretëve duhet të përmbajë dokumentacionin i cili vërteton përmbushjen e kërkesave si më poshtë vijon:

### 3.1. Kërkesat juridike

- a. Kërkesat juridike për aplikimin për rinovimin e autorizimit janë të njëjta me ato të përcaktuara në nenin 9, pika 2.1.

### 3.2. Kërkesat teknike

- a. Përshkrim mbi përmbushjen e kushteve teknike të përcaktuara në autorizimin e mëparshëm që ato kërkojnë të rinovojnë, gjatë periudhës së vlefshmërisë së këtij autorizimi.
- b. Projekti teknik i instalimit dhe shfrytëzimit të aparaturave, shoqëruar me bllokskemat të cilat paraqesin realizimin e shërbimit deri tek përdoruesi fundor.
- c. Lista e pajisjeve teknike që do të përdoren për ofrimin e shërbimit, tipi dhe karakteristikat teknike të tyre.
- d. Përshkrimi e sistemit dhe mënyrës së faturimit të abonentit.
- e. Deklaratë e aplikuesit për rinovim autorizimi, se kërkesat teknike janë në përputhje me kushtet e miratuara në autorizimin në fuqi dhe nuk ka ndryshim të këtyre të fundit. Kërkesat e përcaktuara në pikën 3.2 (a-d) plotësohen vetëm kur parashikohen ndryshime të kushteve teknike në aplikimin për rinovimin e autorizimit.

### 3.3. Kërkesat lidhur me mbikëqyrjen

- a. Kërkesat lidhur me mbikëqyrjen për aplikimin për rinovimin e autorizimit janë të njëjta me ato të përcaktuara në nenin 9, pika 2.3.

### 3.4. Kërkesat mbi burimet njerëzore

- a. Kërkesat për burimet njerëzore për aplikimin për rinovimin e autorizimit janë të njëjta me ato të përcaktuara në nenin 9, pika 2.4, përveç germës c, e cila kërkohet si më poshtë: *“Pagesat e detyrimeve të sigurimeve Shoqërore për punonjësit e siguruar (jo më pak se 3 për të gjithë periudhën e mëparshme të autorizimit), të paraqitura në formën e një vërtetimi të marrë nga organi kompetent”*.
- b. Përgjashtimisht, OSHMA-të që operojnë në bashki ku numri i banorëve është më i vogël se 30.000, pagesat e detyrimeve të sigurimeve shoqërore për punonjësit e siguruar (jo më pak se 2 (dy) për të gjithë periudhën e mëparshme të autorizimit) të paraqitura në formën e një vërtetimi të marrë nga organi kompetent ose nëpërmjet marrëveshjeve/kontratave me palë të treta në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### 3.5. Kërkesat ekonomike

- a. Kërkesat ekonomike për rinovim autorizimi janë të njëjtat ato të përcaktuara në nenin 9, pika 2.5, përveç gërmës e.

## Neni 11

### DOKUMENTACIONI PËR APLIKIMIN PËR ZGJERIMIN E ZONËS SË OFRIMIT TË SHËRBIMIT

1. AMA gjatë shqyrtimit të aplikimit për zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit të subjektit të pajisur me autorizim për ofrimin e shërbimit për përsëritje të programit audio dhe/ose audioviziv verifikon respektimin e kushteve teknike, juridike, organizative, financiare, e programore për periudhën që ka ushtruar veprimtari audio dhe/ose audiovizive.
2. Aplikimi për zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit për autorizimit për përsëritjen e shërbimit të programit audio dhe/ose audioviziv të të tretëve duhet të përmbajë dokumentacionin i cili vërteton përmbushjen e kërkesave si më poshtë vijon:

#### 1. Kërkesat juridike

- a. Emërtimi, vendndodhja e subjektit që depoziton aplikimin
- b. Ekstrakti i thjeshtë dhe historik për të dhënat e subjektit lëshuar nga Qendra Kombëtare të Licencimit (QKB) për subjektin, që bën kërkesën, bashkë me emrin dhe firmën e personit, që ka të drejtë ta përfaqësojë atë, kur nuk përfaqësohet direkt nga përfaqësuesi ligjor lëshuar jo më vonë se 30 ditë nga paraqitja e aplikimit.
- c. Zona ku subjekti kërkon të zgjerojë ofrimin e shërbimit audioviziv.
- d. Emërtimi tregtar i ofruesit të shërbimit dhe rrjetit ku do të mbështetet.
- e. Certifikata e Konfirmimit të Njoftimit lëshuar nga AKEP.

#### 2. Kërkesat teknike

- a. Përshkrim të përgjithshëm të shërbimit që kërkohet të ofrohet.
- b. Projekti teknik i instalimit dhe shfrytëzimit të pajisjeve, shoqëruar me bllokskemat të cilat paraqesin realizimin e shërbimit deri tek përdoruesi fundor (mënyrat e lidhjes).
- c. Lista e pajisjeve teknike që do të përdoren për ofrimin e shërbimit, tipi dhe karakteristikat teknike të tyre.
- d. Fazat e implementimit të projektit për realizimin me mbulim të zonës së shërbimit ku subjekti kërkon të zgjerojë aktivitetin.

#### 3. Kërkesat mbi burimet njerëzore

- a. Vetëdeklarim mbi mënyrën e re të organizimit të stafit në zbatim të kriterëve fillestare të aplikimit.
- b. Vetëdeklarim mbi ndryshimet e Bordit Drejtues në zbatim të kriterëve fillestare të aplikimit.

#### **4. Kërkesat ekonomike**

- a. Dokumentet që vërtetojnë të dhënat zyrtare e bankare mbi kapitalin financiar të personit juridik apo fizik që bën kërkesën për rastin e zgjerimit të zonës së ofrimit të shërbimit.
- b. Plani ekonomiko-financiar për periudhën e mbetur të vlefshmërisë së autorizimit ekzistues vetëm në rastin e kërkesës për zgjerim zone të ofrimit të shërbimit.

#### **5. Kërkesat lidhur me mbikëqyrjen**

- a. Kontrata/t paraprake ose kontrata/t për kalimin e të drejtave të transmetimit me OSHMA-të mbajtëse të këtyre të drejtave, ku të përfshihet/n edhe zona/t e përcaktuara në kërkesën për zgjerim zone, origjinal ose kopje e noterizuar.
- b. Lista e programeve që do të ritransmetojë sipas kontratës.
- c. Adresa e detajuar e ambientit (studios) ku janë të instaluar pajisjet audiovizive transmetuese të subjektit, e shoqëruar me kopje të noterizuar të dokumentit të pronësisë. Në rast se subjekti ka më shumë se një ambient (studio), adresat e detajuara të secilës prej tyre. Në rast se ambienti nuk është në pronësi të aplikuesit, së bashku me dokumentin e pronësisë duhet të depozitohet edhe dokumenti që vërteton të drejtën e tij të shfrytëzimit (kontratë përdorimi, qiraje, etj.).

### **Neni 12**

#### **ZVOGËLIMI I ZONËS SË OFRIMIT TË SHËRBIMIT PËR PËRSËRITJEN E SHËRBIMIT TË PROGRAMIT AUDIO DHE/OSE AUDIOVIZIV TË TË TRETËVE**

1. Aplikuesi i cili kërkon të zvogëlojë zonën e ofrimit të shërbimit për përsëritjen e programit audio dhe/ose audioviziv të të tretëve duhet të paraqesë pranë AMA:
  - a. Kërkesë për zvogëlimin e zonës së shërbimit për përsëritjen e programit audio dhe/ose audioviziv të të tretëve.
  - b. Kur është i aplikueshëm dhe Certifikata e Konfirmimit të Njoftimit lëshuar nga AKEP e përditësuar.
  - c. Ekstraktin e thjeshtë të QKB-së.

### **Neni 13**

#### **HEQJA DORË NGA AUTORIZIMI**

1. Aplikuesi i cili kërkon të heqë dorë nga autorizimi duhet të paraqesë pranë AMA:
  - a. Kërkesë me shkrim për heqje dore nga autorizimi.
  - b. Ekstraktin e thjeshtë të QKB-së ku në objektin e veprimtarisë të subjektit të mos jenë përfshirë shërbimet në fushën e shërbimeve audiovizive.

### **Seksioni III**

#### **PROCEDURA E SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT**

## **Neni 14**

### **Shqyrtimi i Aplikimit**

1. AMA merr në shqyrtim aplikimin e subjektit, që ka paraqitur kërkesë për marrjen ose rinovimin e autorizimit, ose zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit për subjektet e pajisur me autorizim pasi subjekti ka shlyer pagesën përkatëse të përpunimit të dokumentacionit.
2. AMA vendos për aplikimin e depozituar brenda 30 ditëve nga depozitimi i aplikimit, të plotësuar me të gjitha kërkesat ligjore dhe ato të kësaj rregulloreje, për autorizim. Nëse AMA nuk shprehet zyrtarisht brenda këtij afati, autorizimi konsiderohet i miratuar.
3. Pika 2 e këtij neni nuk zbatohet për aplikimet të cilat rezultojnë me të meta dhe jo në përputhje me kërkesat ligjore dhe ato të kësaj rregulloreje.
4. Vendimi i AMA-s për pranimin ose rrëzimin e aplikimit merret në përputhje me ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe dispozitave të ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”.
5. Autorizimi për shërbimin e programit audio dhe/ose audioviziv dhe përsëritjen e programit audio/audioviziv të të tretëve, nuk i jepet subjektit që i është hequr ose i është bërë e pavlefshme licenca apo autorizimi, me vendim të AMA-s, nëse nuk ka kaluar të paktën një periudhë 5 vjeçare nga data kur i është hequr licenca e transmetimit ose autorizimi.
6. AMA nuk lëshon autorizim ose riautorizim ndaj subjekteve juridikë, aksionarë/ortakë të të cilëve janë individë që kanë qenë, ose janë aksionarë/ortakë në subjekte të cilëve:
  - a) iu është hequr licenca ose autorizimi me vendim të AMA-s;
  - b) licenca ose autorizimi iu është bërë e pavlefshme për shkak të ligjit;
  - c) AMA ka nisur procedurën për heqjen e licencës ose autorizimit;
  - d) kanë detyrime financiare të pashlyera ndaj AMA-s;
  - e) Kanë sanksione me gjobë të pashlyera.
7. Forma dhe përmbajtja e autorizimit përcaktohet me Vendim të AMA-s.
8. Kundër vendimit të AMA-s, për rrëzimin e aplikimit për marrje autorizimi, rinovimin e autorizimit dhe zgjerimit të zonës së ofrimit të shërbimit mund të bëhet ankim në gjykatë, në përputhje me ligjin nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

## **Neni 15**

### **Lirimi i garancisë bankare**

1. Subjekti ka të drejtë të kërkojë lirimin e garancisë bankare në rastet kur plotësohen kushtet e mëposhtme:
  - a. ka filluar ofrimin e shërbimit; dhe
  - b. subjekti ka shlyer pagesën vjetore për autorizim dhe pagesën për marrje autorizimi, brenda afatit 90 ditor nga data e marrjes së autorizimit.
2. Në rast se pas 90 ditëve nga momenti kur merr dijeni zyrtarisht për miratimin e autorizimit, subjekti nuk e tërheq autorizimin, ose nuk realizon detyrimet financiare të parashikuara me ligj, përveç aplikimit të nenit 68/d të Ligjit Nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, garancia bankare konfiskohet nga AMA për pjesën e detyrimit të lindur, kurse pjesa e mbetur ç’ngurtësohet menjëherë.

3. Në rast se aplikimi i paraqitur është refuzuar nga AMA, garancia bankare ç'ngurtësohet menjëherë pas vendimit për refuzimin e aplikimit.

## **Neni 16**

### **Detyrime të subjekteve të autorizuar**

1. Subjekti që pajiset me autorizim ose i rinovohet autorizimi nga AMA, është i detyruar të japë të dhëna/informacionin e duhur pranë AMA-s, në zbatim të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Subjekti që pajiset me autorizim nga AMA për shërbimin OTT, është i detyruar të deklarojë çdo gjashtë muaj, të dhënat mbi numrin aktual të abonentëve dhe tarifën mujore/vjetore të aplikuar për paketat e ofruara.
2. Subjekti që pajiset me autorizim ose i rinovohet autorizimi për ofrimin e njërit apo më shumë shërbimeve të parashikuara në këtë rregullore është i detyruar që:
  - a. Të garantojë ruajtjen e ambienteve ku ndodhen pajisjet transmetuese audio/audiovizive për të ndaluar përdorimin e tyre nga persona të paautorizuar;
  - b. Të garantojë ofrimin e shërbimit për përdoruesit pa ndërprerje 24/7 (sipas grafikut kohor të përcaktuar në rregulloren 101, datë 07.06.2017 “Për procedurat e inspektimit të veprimtarisë audiovizive të ofruesve të shërbimit mediatik audio dhe/ose audioviziv”, e ndryshuar), dhe me cilësi në përputhje me standardet teknike të përcaktuara në kushtet e autorizimit.
  - c. Të garantojë prezencën e të paktën një punonjësi ose të një personi të autorizuar prej tij, në çdo kohë (24 orë në ditë, për 7 ditë të javës), në vendin/ambientin ku janë të vendosura pajisjet audiovizive dhe në çdo ambient ku emetohet sinjali i transmetimit audio dhe/ose audioviziv, si dhe të lejojë inspektimin e tyre nga inspektorët e AMA-s, në bazë të rregullores përkatëse të AMA-s “Mbi procedurat e inspektimit të veprimtarisë audiovizive të ofruesve të shërbimit mediatik audio dhe/ose audioviziv”.
  - d. Të përdorë në marrëdhënie me të tretët emrin tregtar si OSHMA në përputhje me autorizimin e lëshuar nga AMA.
  - e. Të paraqesë kanalin informativ që përdor subjekti OSHMA si kanalin e parë në renditjen e programacionit, ku të jenë të paraqitura logoja e subjektit, data dhe ora e transmetimit. Në këtë faqe duhet të jenë të paraqitura të dhënat e kontaktit dhe nuk lejohet asnjë transmetim tjetër audio/audioviziv brenda kanalit.
3. Subjekti që pajiset me autorizim ose i rinovohet autorizimi nga AMA, është i detyruar:
  - a. të jetë përgjegjës në lidhje me interesat dhe ndjeshmërinë publike, të respektojë mirëkuptimin dhe bashkekzistencën shoqërore të të gjithë individëve në Republikën e Shqipërisë, të respektojë kërkesat e ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe kushtet e autorizimit, të përcaktuara nga AMA.
  - b. të nxisë vlerat demokratike të përcaktuara në Kushtetutën e Shqipërisë dhe në veçanti të drejtën e lirisë së shprehjes dhe të informimit, të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me të.
4. Subjekti që pajiset me autorizim ose i rinovohet autorizimi nga AMA, duhet të njoftojë AMA-n për çdo ndryshim në të dhënat e paraqitura për marrjen e autorizimit, brenda 30 ditëve nga kryerja e tyre. Në mënyrë të veçantë, ndryshimi i ambientit (studios) ku janë të instaluar pajisjet transmetuese audiovizive dhe/ose shtimi i një ambienti të ri duhet të bëhet

vetëm pas njoftimit në AMA dhe dorëzimit të dokumentacionit të mëposhtëm:

- a. adresa e detajuar e ambientit (studios) së ndryshuar, ose të shtuar;
  - b. kopje e noterizuar e dokumentit të pronësisë;
  - c. dokumenti që vërteton të drejtën e shfrytëzimit (kontratë përdorimi, qiraje, etj.) në rast se ambienti i ri nuk është në pronësi të subjektit.
  - d. Projekti teknik i detajuar ku të pasqyrohen ndryshimet përkatëse.
5. Autorizimi është i patjetërsueshëm dhe vlen vetëm për të autorizuarin. Në rast se i autorizuari hyn në marrëdhënie juridike civile, objekt i të cilave është edhe veprimtaria e autorizuar, atëherë për cedimin ose kalimin e të drejtave që burojnë nga autorizimi kërkohet miratimi i AMA-s. Subjektit që ka fituar këto të drejta, miratimi i jepet në formën e një autorizimi të ri me të njëjtën përmbajtje. Kur AMA nuk e miraton kalimin, për shkaqe të parashikuara në ligj, autorizimi është i vlefshëm vetëm për subjektin i cili ka kërkuar cedimin tek një subjekt tjetër, pra tek subjekti i cili disponon autorizimin.
6. Subjekti i pajisur me autorizim nga AMA dhe subjekti të cilit i kalohen të drejtat e autorizimit paraqesin pranë AMA-s, njoftim të përbashkët për ndryshimet e kryera si dhe kërkesën për miratimin e kalimit të të drejtave të autorizimit, shoqëruar me kontratën noteriale të shitjes/dhurimit dhe ekstraktet historike për të dhënat e subjekteve tregtare palë të kontratës së shitjes/dhurimit.

### **Neni 17**

#### **Detyrimet financiare**

1. Pagesat vjetore për autorizim do të kryhet bazuar në vendimin e AMA-s nr. 5, datë 22.05.2013 *“Mbi miratimin e pagesave për autorizim”*, i ndryshuar, ndërsa pagesat për përpunimin e dokumentacionit dhe pagesat për marrjen e autorizimit, do të kryhen bazuar në vendimin e AMA-s nr. 6, datë 22.05.2013 *“Mbi miratimin e pagesave për shërbimet që kryhen nga Autoriteti i Mediave Audiovizive”*, i ndryshuar.
2. Pagesa vjetore për autorizim kryhet brenda tremujorit të parë të vitit kalendarik. Në rastin kur pagesa kryhet pas kalimit të këtij afati, aplikohet një kamatëvonesë në masën 0.1% të vlerës së pagesës vjetore për çdo ditë vonesë, por jo më shumë se 30% e vlerës së detyrimit financiar.

### **KREU III**

#### **KOHËZGJATJA DHE REGJISTRI I AUTORIZIMEVE**

### **Neni 18**

#### **Kohëzgjatja e autorizimeve**

Autorizimi për shërbimin e programit audio dhe/ose audioviziv dhe autorizimi për përsëritjen e shërbimit të programit audio dhe/ose audioviziv të të tretëve, pavarësisht rrjeteve të komunikimeve ku mbështeten, lëshohet për një afat 5 vjeçar, duke filluar nga data e dhënies së autorizimit, me të drejtë rinovimi.

## **Neni 19**

### **Fillimi i ofrimit të shërbimit**

1. Subjekti sipas nenit 3 të kësaj rregulloreje është i detyruar të fillojë ofrimin e shërbimit brenda 6 muajve nga dhënia e autorizimit nga AMA.
2. Mosfillimi i ofrimit të shërbimit brenda afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni përbën shkak për heqjen e autorizimit.

## **Neni 20**

### **Regjistri i Autorizimeve**

1. AMA administron regjistrin e autorizimeve së bashku me historikun e veprimeve, me anën e një baze të dhënash të aksesueshme për të mundësuar aksesin në distancë.
2. Regjistri i autorizimeve është publik dhe i aksesueshëm në faqen zyrtare të AMA-s.
3. Regjistri i autorizimeve që publikohet do të përmbajë këto të dhëna:
  - i. Emrin e subjektit person fizik/juridik.
  - ii. emri tregtar si OSHMA.
  - iii. numrin e identifikimit të personit të tatueshëm (NIPT).
  - iv. përfaqësuesi ligjor i regjistruar në QKR.
  - v. adresën e ushtrimit të aktivitetit, për zonën e autorizuar.
  - vi. adresën/at e vendit ku subjekti ka/mban pajisjet që përdor për transmetim;
  - vii. të dhënat (telefon, fax, e-mail) të kontaktit me AMA.
  - viii. një përshkrim të shkurtër të aktivitetit që do të kryejë në fushën e shërbimit audio dhe/ose shërbim të programit audioviziv.
  - ix. llojin e rrjetit ku mbështeten shërbimet që ofron.
  - x. numrin dhe datën e lëshimit të autorizimit nga AMA.
  - xi. datën e përfundimit të vlefshmërisë së autorizimit.

## **KREU IV**

### **DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT**

## **Neni 21**

### **Dispozitë kalimtare**

1. Aplikimet për marrjen e autorizimit, rinovimin e autorizimit apo zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit, të depozituara para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, do të shqyrtohen në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore që kanë qenë në fuqi në datën e paraqitjes së aplikimeve.
  - 1.1. Ofruesit e shërbimeve të pajisur me autorizim, rinovim ose zgjerim të zonës së ofrimit të shërbimit mbështetur në rrjet kabllor, satelitor, shërbime online Internet TV, IPTV dhe OTT, kanë afat 3 muaj kohë nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje për rregullim të situatës sipas pikës 9, të nenit 4, të kësaj rregulloreje.
  - 1.2. Aplikimet për marrje autorizimi, rinovim autorizimi apo zgjerim të zonës së ofrimit të

shërbimit mbështetur në rrjet kabllor, satelitor, shërbime online Internet TV, IPTV dhe OTT, të depozituara para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, do të kenë afat 1 muaj për depozitimin e akteve në përputhje me këtë rregullore.

## **Neni 22** **Shfuqizime**

Rregullorja “Për procedurat dhe kriteret e dhënies së autorizimeve”, miratuar me Vendimin nr. 56, datë 10.07.2015 të AMA-s, shfuqizohet.

## **Neni 23** **Hyrja në fuqi**

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Autoriteti i Mediave Audiovizive në përputhje me ligjin nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
2. Kjo rregullore publikohet në faqen zyrtare në internet të Autoritetit të Mediave Audiovizive.